



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA E PËRMBARIMIT TIRANË

Nr. 2216 Prot

Tiranë, më 03.03.2020

V E N D I M P Ë R
SHPALLJEN E SHITJES NË ANKAND TË PASURISË SË PALUAJTSHME

Unë Laureta Kusi Përmbaruese Gjyqësore pranë Zyrës Përmbarimore Tiranë pasi u njoha me materjalet e dosjës përmbarimore bazuar në Urdhërin e Ekzekutimit Nr.2406 akti dt. 03.05.2011 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

KONSTATOVA:

Se është depozituar pranë Zyrës së Përmbarimit Tiranë kërkesa e kreditorit Banka Kombëtare Tregtare sha. se bashku me Urdhërin e Ekzekutimit lëshuar për kontratën e huasë Nr 2596 Rep. Nr.535 Kol dt. 02.06.2008 me palë :

- Kreditor: **Banka Kombëtare Tregtare sha**
- Debitor: **Gëzim Jonuzaj**
- Dorëzues: **Melina Sulejman (Jonuzaj) Shehu**
- Objekti : **Kthim kredie**

Për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, me objekt detyrim për kthim kredie është vendosur sekuestro konservative ne pasurine e paleve debitore:

-Truall+ Apartament Nr.5 me sipërfaqe trualli 31 m2 sipërfaqe ndërtese 41 m2 të ndodhur ne rrugen Mushqetë, Tiranë ne Zonen kadastrale Nr.136 Dt.25.09.2006

- Truall + Dyqan me sipërfaqë totale 63m2 me nr.pasurie i ndodhur në Zonën Kadastrale rurale i rregjistruar në rregjistrin hipotekor Nr.23, Dt. 12.02.2001 të regjistruar në Zyrën Vendore të Rregjistrimit të Pasurise së Paluajtshme Tiranë në emer të debitorit Gëzim Jonuzaj dhe Melina Sulejman (Jonuzaj) Shehu.

Bazuar nenit 564 dhe neni 568 të Kodit të Procedurës Civile, përmbaruesi gjyqësor Laureta Kusi, ka vendosur Caktimin e çmimit për pasurinë

-Truall+ apartament me sipërfaqe trualli 31 m2 sipërfaqe ndërtese 41 m2 të ndodhur ne rrugën Mushqetë, Tiranë në Zonën kadastrale Nr.136 Dt.25.09.2006 të regjistruar në Zyrën Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë në vlerën

1 103 812 (Një milion e njëqind e tremijë e tetëqind e dymbëdhjetë) lekë.

-Truall + Dyqan me sipërfaqë totale 63m2 me nr.pasurie i ndodhur në Zonën Kadastrale rurale i rregjistruar në rregjistrin hipotekor Nr.23, Dt. 12.02.2001 të regjistruar në Zyrën Vendore të Rregjistrimit të Pasurise Paluajtshme Tiranë në vlerën 1 670 760 (Një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtë dhjetë) lekë **rregjistruar në Zyrën Vendore të Rregjistrimit të Pasurise Paluajtshme Tiranë** në emer të debitorëve **Gëzim Jonuzaj dhe Melina Sulejman (Jonuzaj) Shehu.**

Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 567, 568, 569 e 570 të Kodit të Procedurës Civile, une përmbaruese gjyqësore Laureta Kusi:

V E N D O S A:

1. Shpalljen e shitjes në ankand të pasurisë
-Truall+ apartament me sipërfaqe trualli 31 m2 sipërfaqe ndërtese 41 m2 te ndodhur në rrugën Mushqetë, Tiranë ne Zonen kadastrale Nr.136 Dt.25.09.2006 **në vlerën 1 103 812 (Një milion e njëqind e tremijë e tetëqind e dymbëdhjetë) lekë.**
-Truall + Dyqan me sipërfaqë totale 63m2 me nr.pasurie i ndodhur në Zonën Kadastrale rurale i regjistruar në regjistrin hipotekor Nr.23, Dt. 12.02.2001 te regjistruar në ASHK-Tirana Rurle 1 në emer të debitorit Gëzim Jonuzaj dhe Melina Sulejman (Jonuzaj) Shehu **në vlerën 1 670 760 (Një milion e gjashtëqind e shtatë dhjetëmijë e shtatëqind e gjashtë dhjetë) lekë.**
2. Shitja e pasurisë në ankand do të bëhet ditën e **Mërkurë**, me datë **25.03.2020**, ora **16.00**, në Zyrën e Përmbarrimit Tirane,
3. Çdo ofertues që është i interesuar për blerjen e pasurisë/pasurive në ankand, është i detyruar të paraqitet personalisht dhe/ose nëpërmjet përfaqësuesi të tij/saj me prokurë, si dhe **të dorëzojë (brenda në zarf të mbyllur) në zyrën e përmbarruesit gjyqësor deri në orën 16:00, këto dokumenta:**
 - a) kërkesën e tij/saj për pjesëmarrje në ankand;
 - b) faturën bankare të 10% të garancisë për pjesëmarrje në ankand (në original);
 - c) dokumentin e identifikimit (Kartë identiteti ose Pasaportë). Në rast se ofertuesi është person juridik, përveç dokumenteve që paraqet çdo person fizik, përfaqësuesi ligjor duhet të paraqesë statusin, aktin e themelimit të personit juridik, një kopje të ekstraktit historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe një kopje të certifikatës së regjistrimit dhe/ose dokumente të tjera që parashikon ligji “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
4. Çdo ofertues që merr pjesë në ankand, përpara fillimit të procedurave të shqyrtimit të ofertave, ditën e **Mërkurë**, me datë **25.03.2020**, ora **16.00**, është i detyruar të depozitojë si garanci prane Bankës “Credins”, Tiranë në Nr. Llog 818181 së Zyrës së Përmbarrimit Tirane një shumë të hollash të barabartë me 10 % të çmimit të pasurisë/pasurive të caktuar në shpallje. Kreditori nuk le garanci, në rast se kredia e tij e kalon masën e garancisë.
5. Debitori dhe/ose përfaqësuesi i tij ligjor, përmbarruesi gjyqësor, si edhe personat e tjerë që listohen në nenin 709 të Kodit Civil, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand. Kur sendi blihet nga një person që nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ankand, shitja është e pavlefshme. Në këtë rast, shuma e lënë si garanci nga blerësi kalon në dobi të shtetit dhe sendi me kërkesë të secilit kreditor mund të shitet përsëri në ankand, duke vepruar sipas rregullave të caktuara në Kodin e Procedurës Civile.
6. **Gazeta “Shqiptare” dhe Gazetën “Shekulli”**, sipas detyrimit që rrjedh nga neni 568 i Kodit të Procedurës Civile, këtë vendim detyrohen ta publikojnë **5(pesë) ditë me radhë**, në gazetat e tyre. Për shërbimin e kryer, pala kreditore merr persiper pagimin e shumës e cila më pas sipas nenit 525 do ti llogaritet palëve debitore .
7. Pala kreditore duhet te paraqese tek permbarruesi gjyqësor nje kopje te faqeve te gazetave te cilat kane publikuar vendimi **5(pesë) ditë me radhë**. Ky vendim hartohet në **9 (Nëntë)** kopje. Një kopje administrohet në dosjen përmbarrimore **1(një)** kopje afishohet në ambientet e Zyrën e Përmbarrimit Tirane **1(një)** kopje afishohet në vendin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme; **1(një)** kopje i njoftohet debitorit; **1(një)** kopje i njoftohet kreditorit; **2(dy)** kopje iu njoftohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane dhe Bashkisë Tiranë, për afishim në ambjentet e tyre publike, si dhe **2(dy)** kopje iu njoftohen për publikim, **Gazetës “Shqiptare” dhe Gazetës “Shekulli”**.

PËRMBARRUESE GJYQËSORE

Laureta KUSI

